



Pranimi / Dorezimi / Prilaz / Podatimi / Received / Delivered	14.01.2022	2	viti / god / Year
Organ / Ijesta / Organ / Jednica / Org / Unit	Dr. Prot / Br. Prot / Prot No	Shtesa / Pulog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKDMSHICK	172/2022		1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.1184/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi - Bajraktari, anëtare, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.52/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.725/2019 të datës 21.11.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë:

kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 14.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.725/2019 e datës 21.11.2019 e parashtruar nga ankuesi nga Prishtina.

A r s y e t i m

Komuna e Prishtinës, me datë 17.09.2019 ka shpallur konkursin me numër reference 14-111/01-228004/19 për pozitën e punës "Udhëheqës i Sektorit të Sportit" në kuadër të Drejtorisë së Sportit, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi Komisioni Përzgjedhës për Shërbimin Civil (KPSHC) pranë Komunës së Prishtinës, në fazën e vlerësimit të aplikacioneve kishte konstatuar se ankuesi nuk i plotëson kriteret e konkursit dhe rrjedhimisht të njëjtit i kishte refuzuar aplikacionin. I pakënaqur me njoftimin e datës 28.10.2019 lidhur me mos përfshirjen e tij në listën e ngushtë, ankuesi me datën 21.11.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5475/2019 të regjistruar me numër A.nr.725/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.11.2019, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë të Komuna e Prishtinës. Komuna e Prishtinës më datë 11.01.2021 ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me shkresat e procedurës së zhvilluar me provat e bashkangjitura të lëndës dhe është protokolluar me numër 60/2022.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë kuorumi për vendosje, me datë 13.12.2019, përmes shkresës me numër protokoll 5815/2019 ka njoftuar ankuesin për pamundësinë e shqyrtimit të ankesës më numër A.nr.725/2019 të datës 21.11.2019, duke udhëzuar të njëjtin për të drejtën e inicimit të padisë në pajtim me dispozitat e LKA-së.

Pas këtij njoftimi, ankuesi ka iniciuar konfliktin administrative pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa kjo e fundit përmes Aktgjykimit A.nr.52/2020, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, ka anuluar njoftimin e datës 13.12.2019, dhe ka obliguar Këshillin që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën A.nr.725/2019 të datës 21.11.2019.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën e datës 21.11.2019 me numër protokoll 5475/2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e konkursit e datës 17.09.2019; Njoftimi i datës 19.11.2019 për kandidatin e suksesshëm për pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Sportit" në kuadër të Drejtorisë së Sportit; Njoftimi i datës 28.10.2019 nga Sektori i burimeve njerëzore për listën e ngushtë; E-mail zyrtar i datës 23.10.2021; Padi e datës 10.01.2020 e ushtruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Padia e datës 23.09.2019; Aktgjykimi A.nr.52/2020 i datës 19.11.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 11.01.2022 me numër protokoll 60/2022; E-mail zyrtar i datës 06.01.2022; Autorizimi i MAP-it i datës 11.09.2019; Kopja e konkursit e datës e datës 17.09.2019; Data e pranimit të aplikacioneve për pozitën "Udhëheqës i sektorit të sportit"; Njoftimi i datës 28.10.2019 me nr.14-111/01-0263262/19 për mos përfshirje në listën e ngushtë Lista e kandidatëve të cilët janë përfshirë në listën e ngushtë te datës 30.10.2019; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 01.11.2019; Përmbledhja e vlerësimeve individuale nga Komisioni Përzgjedhës; Njoftimi i datës 19.11.2019 me nr.14-111/01-284566/19 për kandidatin e përzgjedhur; Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë e datës 28.10.2019 për Aplikacioni për punësim i datës 23.09.2019 me nr.14-111/01-0233109/19 për Kopja e letërnjoftimit; Diplomë e datës 18.12.2012 me nr.312 e lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës; Diploma e datës 05.11.2015 e lëshuar nga Fakulteti Juridik- Bachelor i Drejtësisë; Certifikatë e muajit dhjetor 2009; Certifikatë e datës 29.10.2009; Certifikatë e muajit qershor 2009; Certifikatë e lëshuar nga Giz; Certifikatë e muajit mars 2018; Certifikatë e vitit akademik 2010/2011; Vërtetim i datës 07.05.2019 për përvojën e punës në Komunën e Prishtinës; Vërtetim për punësim i datës 29.01.2015; Vërtetim i datës 17.06.2014; Certifikatë e datës 18.01.2015; Informata personale për Kërkesa për punësim e datës 25.09.2019 për Kopja e letërnjoftimit; Vërtetim i vitit 2019; Certifikatë e datës 05.04.2011; Certifikatë e datës 25.09.2014; Certifikatë e datës 12.12.2008; Diploma e datës 24.11.2009 me nr.2209 e lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës dhe pliko postare e lëshuar në postë me datën 25.09.2019 ndërsa në zyrën e burimeve njerëzore në Komunën e Prishtinës ka arrit me datën 27.09.2019;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se Komuna e Prishtinës, me datë 17.09.2019 ka shpallur konkurs të brendshëm për pozitën e punës "Udhëheqës i Sektorit të Sportit" me numër reference 14-111/01-228004/19.





Organi i punësimit, në përgjigjen e dhënë në ankesë, me datë 12.01.2022, pretendon se ankuesi për pozitën e punës "Udhëheqës i Sektorit të Sportit" të shpallur me datë 17.09.2019 ka aplikuar jashtë afatit të përcaktuar në konkurs.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, administroi shkresat e lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë dhe rrjedhimisht gjatë administrimit të provave konstatoi se për pozitën e punës "Udhëheqës i Sektorit të Sportit" afati i aplikimit ka qenë nga data 18.09.2019 deri me datë 24.09.2019.

Ankuesi me qëllim të aplikimit në këtë pozitë të punës, me datë 25.09.2019 ka dorëzuar aplikacionin në postë, ndërsa aplikacioni është pranuar me datë 27.09.2019 nga Zyra e Personelit në Komunën e Prishtinës. Bazuar në këtë, Kolegji konstaton se ankuesi ka aplikuar jashtë afatit të përcaktuar në konkurs, sepse sipas konkursit të shpallur afati për aplikim ka qenë nga data 18.09.2019 deri me datë 24.09.2019, ndërsa ankuesi ka dorëzuar aplikacionin me datë 25.09.2019.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 22 paragrafit 2 ku përcaktohet se: *Aplikacionet e pranuar pas afatit të përcaktuar konsiderohen të pranueshme, nëse data në dërgesën postare ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmonë se ajo është dërguar para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve*, dhe duke marr parasysh se në konkurs ceket se: *Fletë aplikacionet e kandidatëve me dokumente të pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk do të merren në shqyrtim*, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, konstaton se Komisioni Përzgjedhës pranë Komunës së Prishtinës me rastin e refuzimit të aplikacionit të ankuesit ka vepruar në pajtim me nenin 22 paragrafi 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, dhe rrjedhimisht pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar.

Kështu që pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**

**Lënda A.nr.1184/2021, 14.01.2022**

Sabile AVDYLI

*Sabile Avdyli*

Procesmbajtëse



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit,
- Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-gjyqtarja
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

